

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot ne daten 22.11.2021 (dymije e njëzet e një), lidhet kjo kontrate shitje kuotash midis:

PALA SHITSE:

Enio HAXHIU, atesia Bashkim, i lindur ne Rreshen, me date 13.12.1991, dhe banues ne adresen: Shijak, Maminas, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit 034503496 dhe numer personal J11213074D.

Në këtë akt në cilësinë e titullarit pronar te sendit objekt kontrate.

PALA BLERESE :

Florjand HIDA, atesia Bajram, i lindur me 30. 01. 1988, ne Tirane, dhe banues ne adresen: Tiranë, TIRANË, MIHAL GRAMENO; Nd. 64; H. 1; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2; NJËSIA BASHKIAKE NR. 2 madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, mbajtes i pashaportes numer BD2470463 dhe numer personal I80130074U.

Këtu e në vijim « Pala Blerese».

Palet, me vullnet të lirë dhe të plotë, të informuar e në dijeni të pasojave ligjore ne rast deklarimi te pa vertete, hartojne këtë akt.

RRETHANA PARAPRAKE

1. Shoqeria "ENLED" shpk eshte regjistruar si person juridik shqiptar me pergjegjesi te kufizuar, e identifikuar me numer NUIS: L81401016B ka status aktiv, nuk evidentohen barresime e marrveshje kufizuese mbi pjeset e kapitalit te shoqërisë.
2. Pala shitëse, Ortak i vetëm në Shoqeri deklaroi se Shoqëria "ENLED" sh.p.k, është shoqëri aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është nën sekuestro apo nën forma të tjera të kufizimit të zotësisë së saj juridike dhe e lire per qarkullim civil te pjeseve te kapitalit te saj.
3. **Enio HAXHIU**, palë shitëse, si më sipër është pronar në Shoqerinë "ENLED" shpk, duke zotëruar:
 - o Numri pjeseve: 1,00 pjese
 - o Pjesëmarrja në përqindje: 100,00 %;

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate eshte:

- Shitja prej Pales Shitese, i 49% (dyzete e nente perqind) te kapitalit qe zoteron ne shoqeri.
- Blerja prej Palës Blerëse, i 49% (dyzete e nente perqind) te kapitalit qe zoteron ne shoqeri.

ÇMIMI I KONTRATËS

Pala Shitese, deklaroi se me deshirë të shprehur, me vullnet te lire e te plote i shet 49% (dyzete e nente perqind) te kapitalit qe zoteron ne shoqeri bleresit Florjand HIDA, i cili me deshirë të shprehur, me vullnet te lire e te plote deklaroi se është dakord qe t'i bleje.

Me marreveshje te perbashket te dy palet kane percaktuar se:

- **Çmimi total per shitblerjen e 49 % (dyzete e nente për qind) të kapitalit është 49 000,00 (dyzet e nente mije) Lek;**
- Palët deklaroi se Çmimi total per shitblerjen eshte likujduar totalisht nga bleresi përpara nënshkrimit të aktit.

Me nënshkrimin e kesaj kontrate, shitësi **Enio Haxhiu** humbet çdo të drejtë pronësie mbi 49 % (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të shoqërisë, në shitje. Blerësi behet pronar i 49 % (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

Me nënshkrimin e kesaj kontrate pronësia mbi kapitalin e shoqërisë do të bëhet si vijon:

- 1- **Enio HAXHIU:** Numri i pjesëve 1 (Një);
Pjesëmarrja në përqindje: 51,00%;
- 2- **Florjand HIDA:** Numri i pjesëve 1 (Një);
Pjesëmarrja në përqindje: 49,00%

DEPOZITIME TË PALEVE

Palet depozitojnë dhe kërkojnë që kontrates ti bashkëngjiten dhe të jenë pjese integrale të saj edhe:

- Ekstrakti Regjistrat Tregetar të Shoqërisë "ENLED" shpk.
- Dokumentacioni i identifikimit të paleve.

Ky akt përpilohet në tre kopje, kopje të aktit ruhen nga palët dhe depozitohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për tu pasqyruar ndryshimi i pronësisë së shoqërisë ENLED shpk sipas detyrimeve ligjore.

Sa më sipër me kërkesë të shprehur të palëve përpilohet kjo Kontratë shitjeje kuotash, e cila lexohet prej palëve.

Palët deklarojnë se e gjejnë tërësisht, e paragraf për paragraf në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, japin pëlqimin e tyre për gjithçka më sipër dhe e nënshkruajn aktin rregullisht duke vendosur emër mbiemër dhe firmë.

PALA SHITËSE
Enio HAXHIU

PALA BLERESE
Florjand HIDA

Enio Haxhiu

Florjand Hida



ENLED sh.p.k.
NUIS: L81401016 B
Tirana - Albania